



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
INSTITUTI PARLAMENTAR

Seminar me temë:

DEMOKRACIA DHE KUVENDI

për nxënësit e shkollave të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Përmbajtjet e seminarit janë zhvilluar dhe realizuar nga Njësia për Edukim dhe Komunikim e Institutit Parlamentar të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Informacione të përgjithshme:

Instituti Parlamentar është njësi e veçantë organizative në Shërbimin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut që funksionon si një qendër për hulumtim, edukim dhe informim, i themeluar mbi parimet e paanshmërisë, arritshmërisë dhe kredibilitetit.

Instituti Parlamentar, ndër të tjera, kryen aktivitete për edukim dhe informim të qytetarëve për punën dhe rolin e Kuvendit (në përputhje me qëllimin e tij strategjik për transparencën e Kuvendit ndaj publikut).

Gjatë vitit, është planifikuar të organizohen dy seminare njëditore për edukimin e nxënësve të shkollave të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut me temë "**Demokracia dhe Kuvendi**". Aktiviteti është një program i veçantë i Njesisë për Edukim dhe Komunikim të Institutit Parlamentar që realizohet si një punëtori që zgjat pesë orët e gjysmë. Këto seminare u dedikohen nxënësve të shkollave të mesme, që në kuadër të lëndëve mësimore mësojnë përmbajtje në lidhje me menaxhimin e shoqërisë dhe pushtetin në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kjo lëndë në programet mësimore të shkollave të mesme profesionale është lënda Arsimit qytetar, që mësohet në vitin e IV. Në programet mësimore të arsimit të mesëm gjimnazist janë lëndët: Sociologjia, Hyrje në të drejtën, Filozofia dhe Etika.

Përshkrimi i seminarit

Aktiviteti edukativ është paramenduar të realizohet si një seminar në kohëzgjatje prej pesë orë e gjysmë. Nëpërmjet përmbajtjeve të përshtatura për moshën e tyre, nxënësit i përcaktojnë dhe zgjerojnë njohuritë e tyre për demokracinë parlamentare dhe zhvillimin e saj historik në Maqedoni, për punën e Kuvendit, zgjedhjen e deputetëve, miratimin e ligjeve dhe tema të tjera të ngjashme. Qasja e trajnuesit është kombinim i ligjëratave teorike, ushtrimeve praktike, lojërave dhe video porjektiveve. Në seminar dominon një qasje interaktive, që supozon përfshirjen e pjesëmarrësve nëpërmjet pyetjeve dhe diskutimeve dhe shkëmbimit të përvojave.

Seminari fillon me vizitë të organizuar në pjesën solemne të ndërtesës së Kuvendit, që përfshin Sallën Maqedonia (salla plenare), sallën Boris Trajkovski, korridorin para Sallës së Kristaltë, Sallën e Kristaltë, Sallën e Komisionit Kushtetues, Dhomën e Ohrid dhe Strugës, Dhomën Përkujtimore të KAÇKM-së, Sallën e Drugdhendjes së thellë, Korridorin e portreteve dhe Sallën nën kupolën e madhe. Nëpërmjet vizitës, pjesëmarrësit kanë mundësinë që nga afër

të njihen me hapësirën në të cilën punojnë deputetët në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Agjenda e seminari përbëhet nga katër sesione tematike. Në sesionin e parë, nxënësit njihen me demokracinë, me ç'rast diskutohet për konceptimet e ndryshme të demokracisë si vlerë, rend politik dhe ideologji. Për më tepër, gjatë sesionit, shpjegohen karakteristikat e sistemit presidencial dhe parlamentar dhe përcaktohet sistemi politik i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe roli i Kuvendit në të.

Sesioni i dytë i kushtohet historisë së parlamentarizmit në Maqedoni, kështu që studentët kanë mundësinë të njihen me të kaluarën, proceset historike, ngjarjet dhe personalitetet që kanë lënë gjurmë në historinë e parlamentarizmit në Maqedoni.

Qëllimi i sesionit të tretë është që nëpërmjet lojes me role me qëndrime të kundërta, nxënësit të shohin dallimet midis dialogut dhe debatit, për sa i përket rrjedhës dhe rezultatit të dy stileve të diskutimit publik. Nëpërmjet sesionit nxënësve u mundësohet të zhvillojnë shkathtësitë e tyre komunikuese, negociuese, dhe retorike. Në kuadër të sesioni do të përfshihen edhe deputetë të Kuvendit, në mënyrë që nxënësve t'u tregohet edhe përvoja praktike në lidhje me temën e shqyrtimit të sesionit.

Gjatë sesionit të fundit, nëpërmjet lojërave edukative bëhet një përmbledhje e seminari. Rol kryesor në këtë sesion luan qasja interaktive, e cila supozon përfshirjen e pjesëmarrësve nëpërmjet përgjigjes së pyetjeve të parashtruara dhe diskutimit.

Të gjithë pjesëmarrësve në këtë punëtori do t'u jepen certifikatë për pjesëmarrje.

**Qëllimet e
përgjithshme të
seminari:**

Afrimi i punës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut te popullata e re, që do të kontribuojë në zhvillimin e ndërgjegjësimit të tyre për përfitimet e demokracisë dhe do t'i inkurajojë dhe përgatitë ata për kritikë dhe përfshirje shoqërore dhe politike.

**Numri i
pjesëmarrësve:**

Gjashtë shkolla, numri i pjesëmarrësve nga një shkollë është katër nxënës dhe një mësimdhënës.

Koha:

Dy herë në vit

Vendi:

Qendra edukative e Instituti Parlamentar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Gjuha:

Gjuha maqedonase me përkthim në gjuhën shqipe

Trajnues:

Seminari do të realizohet nga trajnuesit e Njësisë për Edukim dhe Komunikim në Institutin Parlamentar.

Shpenzime:

Pjesëmarrja në seminar është falas dhe përfshin materiale edukative falas, ushqim dhe pije freskuese gjatë evenimentit. Shpenzimet e transportit nga dhe deri në vendin e seminarit i mbulojnë vetë pjesëmarrësit.

**Mënyra e
paraqitjes:**

Çdo shkollë që do të paraqitet, emëron katër nxënës të cilët do të marrin pjesë në seminar dhe një mësimdhënës i cili do t'i shoqërojë. Paraqitja bëhet nëpërmjet platformës softuerike për paraqitje: seminari.sobranie.mk

Kontakti:

E-mail: parl.inst@sobranie.mk
tel: 02/3182 - 227

Qëllimet e përgjithshme të seminarit:

Pas përfundimit të seminarit, pjesëmarrësit:

- do të dinë se çfarë është demokracia, cilat janë përfitimet e saj, do të fitojnë njohuri themelore për karakteristikat e demokracisë parlamentare dhe do të dinë se si ta identifikojnë vendin tonë si demokraci parlamentare;
- do t'i mësojnë datat dhe ngjarjet më të rëndësishme historike nga zhvillimi bashkëkohor i parlamentarizmit maqedonas;
- do të dinë të përcaktojnë se çfarë është ndarja e pushtetit, cilat janë tri degët e qeverisjes në Republikën e Maqedonisë së Veriut, funksionet e tyre themelore dhe kontrolli i tyre i ndërsjellë, si dhe pse kjo është e rëndësishme për demokracinë;
- do të dinë pse dhe si zgjidhen përfaqësuesit e popullit;
- do të dinë t'i identifikojnë kompetencat themelore të Kuvendit dhe do të kenë pasqyrë themelor për procesin e miratimit të ligjeve;
- do të njihen me hapësirën në të cilën punon Kuvendi.

Për arritjen e këtyre qëllimeve, seminari do t'i përfshijë këto përmbajtje:

Përmbajtje	Kohëzgjatja
Vizitë e organizuar në ndërtesën e Kuvendit	60 minuta
Arsimimi politik demokracia dhe qytetaria aktive	45 minuta
Historia e parlamentarizmit në Maqedoni	45 minuta
Punëtorija: Dialogu dhe debati	60 minuta
Përcaktimi i njohurisë nëpërmjet kuizit	15 minuta
Vlerësimi dhe dhënia e certifikatave për pjesëmarrje në këtë seminar	15 minuta